



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 11 maj 2011, në orën 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm, Bezat Halilaj - ZAP, Naim Huruglica – Dogana e Kosovës.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore - KIPRED (staf mbështetës), Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Doganës së Kosovës, për vitin 2010;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Doganës së Kosovës, për vitin 2010

Kryesuesi – I njoftoi anëtarët e Komisionit se i ftuar për mbledhje ka qenë drejtori i Doganës së Kosovës, por ka lajmëruar se ndodhet jashtë vendit, prandaj ka dërguar përfaqësues për shqyrtimin e këtij Raporti. Hap diskutimin.

Ramiz Lladrovci – Tha se pavarësisht kush e cakton drejtorin e Doganës, Komisioni për mbikëqyrje nuk duhet të bëjë lëshime. Meqenëse nuk është i pranishëm drejtori i Doganës, propozoi që shqyrtimi i këtij Raporti duhet të shtyhet për një ditë tjetër.

Armend Zemaj – Ishte i mendimit se përgjegjësia para institucioni duhet të jetë në nivelin më të lartë, pa marrë parasysh angazhimet që mund t'i kemi, sidomos për agjencitë që janë kategori kushtetuese dhe për nga rëndësia janë shumë të veçanta. Ishte i mendimit që as ky Raport të mos shqyrtohet pa praninë e drejtorit të Doganës. Sidomos për kategorinë e institucioneve, që janë në shtytje të lirit nga kompetencat e rezervuara. Pra, para deputetëve, duhet të jenë përfaqësuesit nivelit më të lartë.

Bali Muharremaj – Ishte i mendimit që të jenë të barabartë për të gjithë. Meqenëse shqyrtimi i raportit të AKP-së është shtyrë pikërisht pse nuk kanë prezantuar para këtij Komisioni përfaqësuesit më të lartë, atëherë edhe shqyrtimin e këtij Raporti duhet të shtyhet për shkak të mospranisë së drejtorit të përgjithshëm.

Mursel Haljilji – Në parim dëshiroj që njerëzit më të lartë të japin përgjigje para Komisionit, mirëpo kjo krijon problem. Mendoj se gjithmonë do të ketë raste kur zyrtarët janë në udhëtime zyrtare. Nuk ka mekanizma për sanksionim për mospjesëmarrje në mbledhje të Komisionit. Përkrah qëndrimin e shumicës. Meqenëse raporti kishte të bënte me një veprimtari serioze, ishte i mendimit se të pranishëm duhet të ishin njerëzit më përgjegjës.

Armend Zemaj – Tha se ka mekanizëm sanksionues për mosprezencë të zyrtareve. Në rast se nuk përgjigjet drejtori, atëherë përgjigjet ai që e ka emëruar drejtorin. Ai është ministri i Financave, që e ka propozuar dhe ai që e ka emëruar. Nuk duhet të paragjykojmë që drejtori nuk i është përgjigjur ftesës, por duhet të krijohen praktika serioze që para Komisioni të prezantojë nivelin më të lartë institucional.

Muhamet Mustafa – Duhet t'i detyrojmë që ata t'i përgjigjen ftesës së Komisionit. Ndoshta duhet të jepen njoftime për agjendën dhe të caktohen mbledhjet në një kohë më të përshtatshme. Duhet ta bëjmë një rregull, në të cilën thuhet se Kuvendi është institucioni më i lartë dhe këtu duhet të prezantojnë ata që i fton Komisioni.

Valbona Dibra – Tha se rregull e Komisionit është se para tij duhet të prezantojnë përfaqësuesit më të lartë të institucioneve, pavarësisht asaj se personat e pranishëm të institucioneve janë profesionistë. E gjithë kjo ka të bëjë me nivelin e përgjegjësisë.

Lars Lage OLOFSSON, auditor i përgjithshëm – Në përgjithësi ZAP-i po ofron raporte të detyrueshme të auditimit. Kur bëhet fjalë për Doganën dhe Administratën Tatimore, ato nuk janë shpenzues individualë të buxhetit gjatë vitit 2010. Këto institucione ishin dhe janë pjesë e Ministrisë së Financave dhe auditivi, që e kryen ZAP-i për këto, është më tepër shërbim për ju dhe për ta, sepse sipas marrëveshjeve ndërkombëtare ata janë të detyruar ta bëjnë këtë vetë. Nuk do të kalojë shumë kohë dhe këto organizata do të veprojnë ndaras.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri e nxori këtë

Përfundim

Shqyrtimi i Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të Doganës së Kosovës, për vitin 2010, shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

4. Të ndryshme

a) Diskutim rreth shqyrtimit të Projektligjit për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim

Kryesuesi – Për shqyrtimin e këtij Projektligji është ngarkuar grupi i punës, i formuar në mbledhjen e kaluar. Hap diskutimin.

Valbona Dibra – Meqenëse Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka formuar një grup pune për shqyrtimin e këtij Projektligji, ka angazhuar ekspertë për këtë çështje, propozoj që grupi i punës, i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të jetë pjesë përbërëse e atij grupi pune, në mënyrë që të mos dyfishohet puna e komisioneve për të njëjtën çështje.

Kryesuesi – Ishte i mendimit që Komisioni t'i drejtohet Kuvendit me kërkesën që në trajtimin e këtij projektligji KMFP-ja të jetë pjesë e Komisionit për këtë çështje, e jo ky Komision të kontaktohet nga komisioni tjetër. Pra KMFP-ja shpreh interesim që ta japë kontributin e tij lidhur me këtë çështje. Kuvendi është ai që e ka formuar Komisionin, prandaj, duhet i drejtohem Kuvendit.

Valbona Dibra – Me Rregulloren e Kuvendit janë përcaktuar kompetencat e këtij Komisioni. Me plan të punës pavarësisht që është fleksibil nuk është paraparë shqyrtimi i këtij Projektligji. Duhet të respektohet rregullorja dhe plani i punës. Nuk paraqet problem nëse bisedohet me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Kryesuesi - Kompetencat e këtij Komisioni mund të ndryshojnë me Rregulloren e re të Kuvendit. KMFP-ja duhet t'i drejtohet Kuvendit që me Rregulloren e Kuvendit të qartësohen kompetencat e Komisionit. Nuk duhet të shqyrtohet asnjë raport pa kaluar nëpërmjet këtij Komisioni ose nëpërmjet auditimit. Po ashtu për bordet e formuara auditimi duhet të jetë i performancës e jo i rregullsisë. Komisioni për Buxhet është për ndarje, ndërsa KMFP-ja është për ta vlerësuar nëse ndarja është bërë në përputhje me ligjin ose jo.

Armend Zemaj – Tha se grupi i punës është pajtuar të merret me këtë çështje dhe amendamentet t'i dorëzojë në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Grupi i punës ishte i mendimit, me qëllim që dy komisione të mos dalin me dy propozime lidhur me të njëjtin çështje, të bëhet një grup pune për të. Kompetenca duhet të sqarohet. Qëllimi i këtij Komisioni është kontrollimi i parasë publike. Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e trajton mënyrën e shpenzimit të buxhetit. Propozoi që kryesia e këtij Komisioni të merret me përcaktimin e fushëveprimit të këtij Komisioni. Pastaj, mund të diskutojmë edhe me Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Mursel Haljilji – KMFP-ja ka të bëjë me mbikëqyrjen e financave publike dhe ky Komision është më përgjegjësi të kontrollojë ku është shpenzuar paraja publike dhe si është shpenzuar. Raportet e auditimit i trajtojmë si dokument, mirëpo Komisioni duhet të konstatojë a ka bërë shkelje, në këtë rast Dogana, në shpenzimin e parasë publike. Nëse ka bërë shkelje duhet të përgjigjet para Kuvendit. Nëse sillemi në qark se ky dokument është hartuar në mënyrë të suksesshme, nuk kemi bërë asgjë. Detyra jonë është mbikëqyrja e shpenzimit të parasë publike. KBF-ja ka kompetenca, mirëpo KMFP-ja e ka për kompetencë mbikëqyrjen e shpenzimit të parasë publike. A është shpenzuar paraja publike me destinacion, përse nuk është shpenzuar i tërë buxheti, a ka tepriçë etj. Çështja duhet t'i kalohet Kryesisë, Kuvendit dhe Komisionit për Rregullore.

Ramiz Lladrovci - Tha se KMFP-ja mund t'i procedojë për shqyrtim disa raporte për mënyrën e shpenzimit të mjeteve nga organizatat buxhetore në mbledhje plenare. Organizatat buxhetore

raportojnë para Komisionit për Buxhet dhe Financa për punën e tyre e jo për mënyrën e shpenzimit të buxhetit. Me këtë merret Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Armend Zemaj – Tha se raportet procedohen për shqyrtim në mbledhje plenare, ashtu siç propozohen nga Komisioni. P.sh. raporti për KPM-në është rendit për shqyrtim në mbledhjen e radhës. Por meqenëse Raporti i punës së KPM-së dhe ai i Pasqyrave financiarë janë miratuar në Kuvend, atëherë cili do të jetë rekomandimi i Kuvendit në rastin e miratimit të Raportit të auditimit të Pasqyrave financiare të KPM-së. Asnjë raport që ka të bëjë me shpenzimin e parasë publike të mos procedohet në mbledhje plenare pa raportin e auditimit. Lidhur me kompetencën e Komisioni propozoi të merret kryesia e Komisionit.

Valbona Dibra – Tha se në mbledhje plenare është shqyrtuar dhe është miratuar Raporti i punës së KPM-së, kurse raportet e audituara janë diçka tjetër. Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, OB-të janë të detyruara të raportojnë për Pasqyrat financiare. Për ato Pasqyra financiare ka një afat deri më 31 janar, pastaj raporti i punës deri më 31 mars, mirëpo raportet diskutohen ndaras, sepse kanë të bëjnë me çështje të ndryshme. Bazë e fortë për përfundimin e Kuvendit është Raporti i auditimit. Komisioni nuk mund t'ia kufizoj ZAP-it kohën se kur mund të bëjë auditimin. ZAP-i ka politikën e veta dhe planin punës së tij. Raportet e ZAP-it janë raporte profesionale dhe instrument bazë për Kuvendin.

Kryesuesi - Është shumë e rëndësishme që çdo institucion raportimet t'i dorëzojë deri më 31 mars. Ishte i mendimit se në Kuvend duhet të trajtohen raportet, që kanë arsye për raportim. Pra jo të gjitha raportimet të kalohen në Kuvend. Asnjë raport nuk duhet të shqyrtohet në Kuvend, pa kaluar nëpërmjet këtij Komisioni. Kuvendi në ndryshimin e rregullores duhet t'i inkorporojë edhe këto çështje. Duhet të kërkohet auditimi i ndërmarrjeve shoqërore.

Ramiz Lladrovci – Propozoi që lidhur me këtë çështje kryetari i Komisionit t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike nxori këtë

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike është i interesuar për shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për raportim financiar, kontabilitet dhe auditim.

Pjesë përbërëse e grupit të punës të Komisionit për Buxhet dhe Financa, për shqyrtimin e këtij Projektligji, duhet të jenë edhe anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të emëruar për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu